

VENDIM
Nr. 84, datë 14.2.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1039, DATË 4.12.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR CAKTIMIN
E PËRFAQËSUESVE
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NË KËTË KËSHILL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Kudo në vendim, emërtimi “ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” zëvendësohet me fjalët “... ministri përgjegjës për punën ...”.
 - b) Në pikën 3, pas fjalëve “... në dispozicion të KKP-së ...” shtohen “..., sipas kërkesës, ...”.
 - c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. KKP-ja kryesohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje, si përfaqësues të Këshillit të Ministrave, këta anëtarë:

 - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministrin e Drejtësisë;
 - Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
 - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Përfaqësues, kandidatë të KKP-së, në mungesë të përfaqësuesve, anëtarë të Këshillit të Ministrave, janë zëvendësministrat përkatës.”.
 - ç) Në pikën 6, pas fjalës “... kryetarët ...” shtohen fjalët “... e këtyre dy...”.
2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama